

PROJEKTI KOSOVO SOLAR – TUÇEP DHE VERIQ VLERËSIMI MJEDISOR DHE SOCIAL

Qasja për Menaxhimin e Ndikimeve në Mjetet
e Jetesës nga Përdorimi Joformal i Tokës

Shkurt 2026



CONTENTS

1 HYRJE.....	3
2 PËRSHKRIMI I SHKURT I PROJEKTIT	4
3 PËRDORIMI I TOKËS DHE ÇËSHTJET E LIDHURA ME JETESËN NË KUADËR TË PROJEKTIT ..	5
3.1.1 Toka e Nevojshme për Projektin – Përmbledhje	5
3.1.2 Përdoruesit Joformalë të Tokës së Projektit	6
3.1.3 Masat e Planifikuara për Mbështetjen e Përdoruesve Joformalë të Tokës	9



1 HYRJE

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) po shqyrton mundësinë e financimit të ndërtimit dhe operimit të dy impianteve të mëdha fotovoltaike (IFV) në Kosovë, së bashku me infrastrukturën përkatëse, me një kapacitet të kombinuar prej 142.2 MWp dhe me një sipërfaqe totale prej rreth 140 ha (në vijim: “Projekti”):

- > IFV Tuçep – kapacitet 98.5 MWp; dhe
- > IFV Veriq – kapacitet 43.7 MWp.

Përgjegjësia e përgjithshme për implementimin e Projektit i takon Quant Renewables Kosovo Invest Limited (në vijim “Huamarrësi”), një kompani me seli në Mbretërinë e Bashkuar. Kjo kompani do të jetë përfituesi i drejtpërdrejtë i kredisë nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe do t’i raportojë BERZH-it lidhur me implementimin e Projektit. Fondet e kredisë do t’u kalohen më tej në formë huaje palëve të treta, dy shoqërive lokale me qëllim të posaçëm (ShQP)—AKG Solar Tuçep dhe AKG Solar Veriq, të cilat janë themeluar për të zotëruar dhe operuar impiantet fotovoltaike (IFV) përkatëse. Ndërtimi i IFV-ve do të realizohet nga SolarApex (në vijim “Kontraktori”), një kompani me përvojë që është e specializuar në projekte të energjisë diellore.

Ky dokument paraqet **Qasjen për Menaxhimin e Ndikimeve në Mjetet e Jetesës nga Përdorimi Joformal i Tokës**, të përgatitur në bazë të analizës së kryer për Projektin gjatë periudhës nga tetori 2025 deri në janar 2026. Dokumenti ofron një pasqyrë të përgjithshme të përdorimit joformal të tokës të identifikuar brenda zonës së Projektit, natyrës dhe shkallës së ndikimeve të mundshme në jetesë, si dhe qasjes për menaxhimin e këtyre ndikimeve gjatë zbatimit të Projektit.


Ky dokument është përgatitur për të mbështetur harmonizimin e Projektit me **Kërkesën Mjedisore dhe Sociale 5 të BERZH-it** (Përvetësimi i Tokës, Kufizimet në Përdorimin e Tokës dhe Zhvendosja e Pavullnetshme), veçanërisht në lidhje me përdoruesit joformalë të tokës të cilët mund të përballen me ndikime në jetesën e tyre si rezultat i kufizimeve në qasjen në tokë.

2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

IFV-të Tuçep dhe Veriq do të vendosen brenda Komunës së Istogut. IFV Tuçep do të ndërtohet në afërsi të vendbanimeve Kërrninë dhe Tuçep, ndërsa IFV Veriq do të vendoset në afërsi të vendbanimeve Veriq dhe Veriq i Ri.

Përveç moduleve fotovoltaike, Projekti do të përfshijë edhe infrastrukturën elektrike mbështetëse të nevojshme për të mundësuar transmetimin e sigurt të energjisë elektrike në rrjetin kombëtar. Kjo përfshin punë ndërtimi për tri nënstacione transformatori. Secili IFV do të përfshijë gjithashtu një objekt të vogël administrativ dhe depo.

Një pasqyrë e infrastrukturës së përshkruar është dhënë në figurën më poshtë.



Të dy lokalitetet janë të qasshme përmes infrastrukturës ekzistuese të rrjetit rrugor. Përveç kësaj, si pjesë e Projektit, do të ndërtohen rrugë të brendshme për qasje brenda parcelave të IFV-ve.

3 PËRDORIMI I TOKËS DHE ÇËSHTJET E LIDHURA ME JETESËN NË KUADËR TË PROJEKTIT

3.1.1 Toka e Nevojshme për Projektin – Përmbledhje

Nevoja totale për tokë për Projektin është 141.42 ha, e shpërndarë si vijon:

- > Lokacioni i IFV Tuçep: rreth 92.4 ha, i vendosur në zonën kadastrale të fshatit Tuçep, i përbërë nga 20 parcela;
- > Lokacioni i IFV Veriq: rreth 49.02 ha, i vendosur në zonën kadastrale të fshatit Veriq, i përbërë nga 36 parcela.

Këto dy lokacione përbëhen kryesisht nga tokë bujqësore dhe pjesërisht nga tokë e papunuar.



Pamje nga lokacioni i IFV Tuçep (sipër) dhe IFV Veriq (poshtë) drejt Malit Mokna në veri.

Harta Zonale Komunale (2024–2032) e ka përcaktuar këtë zonë për prodhim të energjisë. E gjithë toka e nevojshme për Projektin është në pronësi shtetërore dhe është objekt i marrëveshjeve afatgjata të qirasë me kompaninë Gekos LLC, e cila ka nënshkruar një marrëveshje qiraje 99–

vjeçare me Qeverinë e Kosovës në vitin 2009. Kjo marrëveshje i mundëson Gekos-it të lidhë marrëveshje të mëtejshme të nënqirasë.

Për rrjedhojë, gjatë viteve 2023 dhe 2024, Gekos ka nënshkruar marrëveshje të tilla të nënqirasë me AKG Solar Tuçep dhe AKG Solar Veriq për:

- > një qira 80-vjeçare për lokacionin e IFV Tuçep; dhe
- > një qira 78-vjeçare për lokacionin e IFV Veriq.

Këto marrëveshje u japin kompanive të Projektit të drejta të plota për të ndërtuar, operuar dhe mirëmbajtur IFV-të gjatë gjithë kohëzgjatjes së Projektit. Siç përcaktohet në marrëveshjet e qirasë, pas përfundimit të periudhës së qirasë, toka do të rehabilitohet dhe do t'i kthehet qiradhënësit në të njëjtën gjendje si në momentin e dorëzimit.

3.1.2 Përdoruesit Joformalë të Tokës së Projektit

Si pjesë e procesit të verifikimit të kujdesit të duhur mjedisor dhe social, Projekti vlerësoi nëse ndonjë individ apo familje po përdorte tokën brenda gjurmës së Projektit në mënyrë joformale. Ky vlerësim u realizua përmes vizitave në terren, pyetjeve lokale dhe intervistave me përdoruesit e identifikuar.

Për Projektin nuk kërkohet zhvendosje fizike apo shpronësim/blerje e tokës rezidenciale në pronësi private. Megjithatë, **vlerësimi konfirmoi se pjesë të tokës së Projektit janë përdorur në mënyrë joformale për qëllime bujqësore nga familjet lokale**. Këta përdorues nuk kanë pronësi ligjore apo të drejta formale qiraje mbi tokën, por disa prej tyre e kanë kultivuar tokën për një periudhë të gjatë kohore dhe e përdorin atë si pjesë të aktivitetëve të tyre bujqësore.

U identifikua një përdorues kryesor joformal i tokës, i cili ka përdorur një pjesë të konsiderueshme të tokës së Projektit për prodhim bujqësor për një periudhë të gjatë kohore. Përveç kësaj, u identifikuan edhe një numër përdoruesish të tjerë joformalë në shkallë më të vogël, të cilët kultivojnë pjesë më të vogla të tokës së Projektit, kryesisht për prodhimin e grurit, misrit, sanës dhe thekrës.

Seksionet në vijim ofrojnë më shumë detaje mbi përdoruesit joformalë të identifikuar të tokës.

1. Përdoruesi kryesor joformal i tokës

Një intervistë me përdoruesin joformal u zhvillua në nëntor 2025. I intervistuari konfirmoi sa vijon:

- > Historiku i përdorimit të tokës:
 - o I intervistuari e ka përdorur tokën për rreth 15 vite.
 - o Ai filloi ta përdorte tokën bazuar në një marrëveshje me Gekos. Ai asnjëherë nuk ka paguar qira apo ka ofruar shërbime në këmbim të përdorimit të tokës.
 - o Kulturat kryesore të mbjella janë gruri (80%), misri dhe luledielli. Toka kultivohet çdo vit.
 - o Ai vazhdon ta përdorë tokën (rreth 80 ha) dhe të korë prodhimet bujqësore. Në tokë nuk ka pemë dhe nuk janë bërë investime.
 - o Ai është i vetëdijshëm se toka i përket një pronari tjetër dhe është i kënaqur që ka pasur mundësi ta përdorë atë për një periudhë të gjatë kohore.
- > Informacioni i marrë lidhur me Projektin:
 - o Ai tashmë është informuar drejtpërdrejt nga AKG Solar se toka do të përdoret për një projekt solar.
 - o Ai është i gatshëm ta lirojë tokën sapo t'i kërkohet.

- Ai nuk ka shqetësime apo sugjerime lidhur me Projektin.
- Ai konfirmoi se i është ofruar mundësia e punësimit.

> Informacioni për familjen:

- Familja përbëhet nga 22 anëtarë, përfshirë 12 fëmijë.
- I intervistuari dhe katër djemtë e tij punojnë tokën. Ata nuk ushtrojnë aktivitete të tjera gjeneruese të të ardhurave jashtë bujqësisë. Anëtarët e tjerë të rritur të familjes kanë punë të tjera.

> Toka alternative:

- Ai zotëron tokë tjetër bujqësore në fshatrat Kashicë dhe Dobrushë, rreth 10 km larg lokacionit të Projektit.
- Kjo tokë tjetër konsiderohet "shumë e përshtatshme" për vazhdimin e aktiviteteve të kultivimit.
- Ai tashmë ka filluar të mendojë për zhvendosjen e aktiviteteve të tij në tokën alternative dhe ka konfirmuar se ka bërë përgatitjet fillestare.
- Ai nuk pret që Projekti të ndikojë në të ardhurat apo aktivitetet e familjes.

Në përfundim, përdoruesi joformal ishte i vetëdijshëm se toka nuk i përkiste atij dhe e kishte përdorur atë me lejen e pronarit të tokës. Familja disponon tokë alternative në afërsi dhe nuk varet nga parcelat e Projektit për të ardhurat e saj kryesore. Duke pasur parasysh se përdoruesi ishte informuar paraprakisht, nuk ngriti kundërshtime dhe do t'i ofrohet mundësia e punësimit, situata nuk përbën zhvendosje ekonomike sipas kërkesave të BERZH-it. Për rrjedhojë, nuk janë identifikuar rreziqe të mbetura lidhur me përdorimin e tokës apo jetesën për këtë përdorues kryesor të tokës.

2. Përdorues të tjerë joformalë të tokës në shkallë më të vogël

U identifikuan edhe pesë përdorues të tjerë joformalë të tokës dhe u arrit të vendosej kontakt me ta. Një seri intervistash u zhvilluan gjatë nëntorit dhe dhjetorit 2025, si dhe në janar 2026¹.

Të intervistuarit konfirmuan sa vijon:

- > Përdorimi i tokës së Projektit: Të gjithë përdoruesit kanë kultivuar tokën e Projektit për një periudhë të gjatë kohore, duke filluar nga viti 1999. Ata menaxhojnë parcela me madhësi të ndryshme, që variojnë nga 0.3 ha deri në 30 ha. Toka përdoret për kultivimin e grurit, misrit, sanës dhe thekrës, ndërsa kultivimi kryhet çdo vit. Detajet për secilin të intervistuar paraqiten më poshtë:

I INTERVISTUARI	KOHËZGJATJA E PËRDORIMIT TË TOKËS	SIPËRFAQJA E PËRDORUR (HA)	FREKUENCIA E PËRDORIMIT	KULTURAT E KULTIVUARA	ASETE NË TOKË	NJOHURIA SE TOKA ËSHTË NË PRONËSI PRIVATE	QIRA APO KOMPENSI MI PAGUAR PËR PËRDORIMIN E TOKËS
1	26 vite	10.0	Çdo vit	Grurë, misër, thekër	Jo	Po	Qira e paguar deri në vitin 2018
2	26 vite	3.5	Çdo vit	Grurë, misër, thekër	Jo	Po	Jo
3	26 vite	1.5	Çdo vit	Grurë, misër	Një hambar bujqësor pjesërisht i vendosur	Jo (i intervistuari besonte se toka ishte	Jo

¹ U identifikua një përdorues i mundshëm i gjashtë joformal i tokës, por ai nuk ishte i interesuar të angazhohej në proces dhe nuk ofroi informacion për qëllimet e këtij vlerësimi.

I INTERVISTUARI	KOHËZGJATJA E PËRDORIMIT TË TOKËS	SIPËRFAQJA E PËRDORUR (HA)	FREKUENCIA E PËRDORIMIT	KULTURAT E KULTIVUARA	ASETE NË TOKË	NJOHURIA SE TOKA ËSHTË NË PRONËSI PRIVATE	QIRA APO KOMPENSI MI PAGUAR PËR PËRDORIMIN E TOKËS
					brenda gjurmës së Projektit	publike)	
4	26 vite	30.0	Çdo vit	Grurë, misër	Jo	Po	Jo
5	26 vite	1.0	Çdo vit	Grurë, misër dhe sanë	Jo	Po	Jo

- > Disponueshmëria e tokës tjetër bujqësore: Të intervistuarit u pyetën lidhur me disponueshmërinë dhe përdorimin e tokës tjetër bujqësore, si dhe aktivitetet e lidhura me të. Të gjithë të intervistuarit raportuan se zotërojnë ose marrin me qira tokë shtesë bujqësore dhe konfirmuan se kjo tokë përdoret në mënyrë aktive për qëllime bujqësore. Për dy prej të intervistuarve, toka shtesë mbështet funksionimin e fermave ekzistuese të qumështit. Detajet për secilin të intervistuar paraqiten më poshtë:

I INTERVISTUARI	A ZOTËRONI OSE MERRNI ME QIRA TOKË TJETËR BUJQËSORE?	A E PËRDORNI KËTË TOKË TJETËR?	A MERRNI SUBVENCIONE NGA QEVERIA?
1	Po, 34 ha në pronësi në afërsi (3–5 km) dhe 14 ha më larg nga toka e Projektit	Po, për të mbështetur funksionimin e fermës familjare të qumështit me 65 lopë	Po, 474 euro për ha grurë dhe 374 euro për ha misër
2	Po, 50 ha me qira në afërsi (3–5 km) dhe 30 ha në pronësi më larg nga toka e Projektit (në fshatin Veriq)	Po, për të mbështetur funksionimin e fermës familjare të qumështit me 60 lopë	E njëjta si më sipër
3	Po, 7 ha në pronësi (ngjitur me lokacionin e Projektit)	Po, për grurë dhe misër	–
4	Po, 3.5 ha në pronësi (2 km larg)	Po, për grurë dhe misër	–
5	Po, 3 ha në pronësi (ngjitur me lokacionin e Projektit – 1.5 ha tokë e punueshme dhe 1.5 ha pyll)	Po	–

- > Informacioni i marrë lidhur me Projektin: Asnjë nga të intervistuarit nuk kishte dijeni për Projektin e planifikuar.
- > Informacioni për familjen dhe cënueshmëria: Familjet e prekura ndryshojnë për nga madhësia, ndërsa disa prej tyre përfshijnë anëtarë të cënueshëm, si të mitur dhe persona të moshuar mbi moshën 65 vjeç. Detajet për secilin të intervistuar paraqiten më poshtë:

I INTERVISTUARI	SA PERSONA JETOJNË NË FAMILJEN TUAJ?	A KA PERSONA TË MOSHUAR, FËMIJË OSE PERSONA QË KANË NEVOJË PËR KUJDES TË RREGULLT?	NUMRI I GRAVE NË FAMILJE
1	11	3 fëmijë, 2 të moshuar (65+)	5 gra
2	13	4 fëmijë	7 gra
3	6	1 i moshuar (65+)	2 gra
4	3	Asnjë	1 grua
5	7	4 fëmijë, 1 i moshuar (65+)	5 gra

- > Ndikimet në mjetet e jetesës: Katër nga pesë familjet presin që Projekti të ndikojë në të ardhurat e familjes së tyre, me ulje të pritshme të raportuara që variojnë nga 10% deri në 30%. Detajet për secilin të intervistuar paraqiten më poshtë:

I INTERVISTUARI	A KRYENI NDONJË PUNË TJETËR JASHTË SEZONIT TË BUJQËSISË?	A KA FAMILJA TË ARDHURA TË TJERA TË RREGULLTA GJATË VITIT?	A DO TË NDRYSHOJË KY PROJEKT TË ARDHURAT APO AKTIVITETET E FAMILJES SUAJ?
1	Jo	Pensionet e prindërve	Po, të ardhurat e familjes do të reduktohen me 30%
2	Jo	Dy anëtarë të familjes punojnë në sektorin privat	Po, të ardhurat e familjes do të reduktohen me 20%
3	Jo	Një anëtar i familjes merr pension	Po, të ardhurat e familjes do të reduktohen me 10%
4	Jo	Një anëtar i familjes punon në sektorin privat	Nuk pritet ndonjë ulje e konsiderueshme e të ardhurave të familjes
5	Jo	Një anëtar i familjes merr pension	Po, të ardhurat e familjes do të reduktohen me 300 EUR në vit

- > Shqetësimet dhe preferencat: Asnjë nga të intervistuarit nuk shprehu shqetësime lidhur me Projektin. Tre të intervistuar shprehën preferencën për të përfituar një lidhje me energji elektrike nga Projekti. *Shënim: Sigurimi i lidhjeve të drejtpërdrejta me energji elektrike për familje individuale ose ferma nuk është parashikuar në kuadër të Projektit. Projekti është projektuar për prodhimin e energjisë elektrike të lidhur me rrjetin dhe nuk përfshin infrastrukturë për furnizim të drejtpërdrejtë me energji elektrike për palë të treta. Si i tillë, sigurimi i qasjes në energji elektrike nuk konsiderohet një masë zbutëse e realizueshme brenda fushëveprimit të Projektit.*

Interes për punësim të lidhur me Projektin u shpreh nga tre të intervistuar.

Njëri nga të intervistuarit ngriti çështjen e hambarit të tij, i cili ndodhet pjesërisht brenda gjurmës së Projektit, dhe kërkoi që të shqyrtohej një marrëveshje me pronarin e tokës, siç është shkëmbimi i tokës, për të shmangur prishjen e tij.

Detajet për secilin të intervistuar paraqiten më poshtë:

I INTERVISTUARI	SHQETËSIME LIDHUR ME PROJEKTIN	SUGJERIME DHE PREFERENCA
1	Jo	Nuk u shprehën.
2	Jo	Nuk shprehu interes për punësim të lidhur me Projektin. I intervistuari deklaroi se do ta mirëpriste një lidhje me energji elektrike nga Projekti për fermën e qumështit (shih shënimin mbi tabelë).
3	Jo	I intervistuari shprehu interes për mundësi punësimi të lidhura me Projektin. Meqenëse një pjesë e hambarit të tij ndodhet brenda gjurmës së Projektit, ai deklaroi se do të pranonte prishjen e pjesshme të hambarit nëse kjo kërkohet nga pronari i tokës; megjithatë, ai sugjeroi që, nëse është e realizueshme, të merret në konsideratë një marrëveshje si shkëmbimi i tokës për të shmangur prishjen. Ai gjithashtu deklaroi se do ta mirëpriste një lidhje me energji elektrike nga Projekti për fermën e qumështit (shih shënimin mbi tabelë).
4	Jo	I intervistuari shprehu interes për mundësi punësimi të lidhura me Projektin. Ai gjithashtu deklaroi se do ta mirëpriste një lidhje me energji elektrike nga Projekti (shih shënimin mbi tabelë).
5	Jo	I intervistuari shprehu interes për një punë me kohë të pjesshme, nëse do t'i ofrohej.

3.1.3 Masat e Planifikuara për Mbështetjen e Përdoruesve Joformalë të Tokës

Të gjithë përdoruesit e identifikuar mbështeten në tokën e Projektit për prodhimin bujqësor, me shkallë të ndryshme varësie nga parcelat e prekura. Megjithatë asnjë nga të intervistuarit nuk shprehu kundërshtime apo shqetësime lidhur me Projektin, katër nga pesë familjet parashikojnë

ulje të pjesshme të të ardhurave, të cilat variojnë nga 10% deri në 30%. Prania e anëtarëve të cenusëshëm të familjes (fëmijë dhe persona të moshuar) në disa familje rrit ndjeshmërinë ndaj ndikimeve në jetesë.

Nga ana tjetër, të gjitha familjet e prekura raportuan se zotërojnë ose kanë qasje në tokë tjetër bujqësore, e cila përdoret në mënyrë aktive për prodhim bujqësor ose për fermat e qumështit. Kjo redukton ndjeshëm rrezikun e ndërprerjes së rëndë ose afatgjatë të mjeteve të jetesës dhe mbështet vazhdimësinë e aktiviteteve kryesore bujqësore. **Për rrjedhojë, nuk pritët që asnjë nga familjet të përjetojë zhvendosje të plotë të jetesës. Megjithatë, duke pasur parasysh përdorimin afatgjatë dhe të vazhdueshëm të tokës së prekur nga familjet lokale, humbja e qasjes në tokë do të rezultojë në ndikime të matshme në jetesën e familjeve. Përveç kësaj, është identifikuar një ndikim specifik për lokacionin që lidhet me një strukturë bujqësore joformale (një hambar), e cila ndodhet pjesërisht brenda gjurmës së Projektit.**

Megjithëse përdoruesit nuk pretendojnë të drejta pronësie apo qiraje mbi tokën dhe kanë shprehur gatishmëri për bashkëpunim, varësia nga toka e prekur për një pjesë të të ardhurave familjare krijon nevojën për masa për menaxhimin e ndikimeve në jetesë, në përputhje me kërkesat e BERZH-it.

Në përputhje me Kërkesën Mjedisore dhe Sociale 5 të BERZH-it (Përvetësimi i Tokës, Kufizimet në Përdorimin e Tokës dhe Zhvendosja e Pavullnetshme), personat që nuk kanë të drejta formale ligjore mbi tokën, por e përdorin atë për qëllime të jetesës, konsiderohen të pranueshëm për mbështetje lidhur me jetesën, kur kufizimet në qasjen në tokë të lidhura me Projektin rezultojnë në ndikime ekonomike.

Për këtë arsye, do të zbatohen masat e mëposhtme:

1. Huamarrësi do të mbajë një **regjistër të përditësuar** të të gjithë përdoruesve joformalë të identifikuar të tokës, duke përfshirë madhësinë e parcelave, kohëzgjatjen e përdorimit dhe shkallën e varësisë së jetesës nga toka e prekur.
2. Siç përcaktohet në Planin e Angazhimit të Palëve të Interesuara të Projektit, Huamarrësi do të organizojë një **takim konsultimi publik** para fillimit të ndërtimit për të bërë publik informacionin mbi Projektin për komunitetet e prekura. Gjatë takimit do të prezantohen fushëveprimi i Projektit, orari i ndërtimit dhe kufizimet në qasjen në tokë, mundësitë e punësimit dhe mekanizmi i ankesave specifik për Projektin. Përdoruesit joformalë të prekur të tokës do të njoftohen paraprakisht për kufizimet në qasjen në tokë dhe aktivitetet ndërtimore, në mënyrë që të mund të përshtatin në kohë aktivitetet e tyre bujqësore, si dhe do të informohen dhe do të kenë qasje në procedura të qarta për paraqitjen dhe zgjidhjen e ankesave.
3. Huamarrësi do të bëjë përpjekje shtesë për t'u ofruar familjeve të prekura trajtim **prioritar për mundësitë e punësimit për punë të pakualifikuara dhe gjysmë të kualifikuara**, nëse plotësohen kërkesat minimale të vendeve të punës. Informacioni mbi afatet e rekrutimit dhe kriteret e përzgjedhjes do të komunikohet paraprakisht. Kjo masë do të zbatohet për individët që shprehin interes për mundësi të tilla.
4. Familjeve që përjetojnë humbje të pjesshme të të ardhurave si rezultat i kufizimeve në qasjen në tokën e Projektit do t'u ofrohet **qasje në tokë alternative bujqësore** nën kontrollin e Huamarrësit, në rast se përdoruesit joformalë të prekur të tokës shprehin interes për këtë mundësi. Qasja do të ofrohet në baza vullnetare dhe për një periudhë të përcaktuar (që do të dakordohet me përdoruesit), e mjaftueshme për të mbështetur vazhdimësinë e prodhimit bujqësor dhe të jetesës. Kur ofrohet tokë alternative, Huamarrësi

mund, në rast se përdoruesit joformalë të prekur të tokës shprehin interes për këtë mundësi, të lehtësojë qasjen në këshillim agronomik për të mbështetur vlerësimin e përshtatshmërisë së tokës dhe tranzicionin e aktiviteteve bujqësore, sipas rastit.

5. Në rastet kur Projekti mund të ndikojë në kulturat ekzistuese ose të pakorrura të kultivuara nga përdoruesit joformalë të tokës, Huamarrësi do të **sigurojë njoftim paraprak të arsyeshëm dhe të mjaftueshëm për të mundësuar korrijen** e tyre para fillimit të ndërtimit. Në rastet kur humbja e kulturave ndodh si rezultat i mosdhënies së njoftimit të duhur paraprak nga ana e Huamarrësit, familjet e prekura do të kompensohen për humbjet e kulturave.
6. Huamarrësi do të **vlerësojë opsionet për të shmangur ose minimizuar ndikimet mbi strukturën bujqësore joformale** (hambarin), e cila ndodhet pjesërisht brenda gjurmës së Projektit, duke përfshirë rregullime të vogla të projektimit ose marrëveshje për shkëmbim toke. Kur shmangia nuk është e realizueshme, Huamarrësi, në konsultim me familjen e prekur, do të identifikojë dhe zbatojë masa proporcionale zbutëse, si zhvendosja ose zëvendësimi i strukturës, para fillimit të ndërtimit në zonën e prekur.
7. Zbatimi i masave zbutëse të lidhura me jetesën do të dokumentohet dhe do të përfshihet në **raportet periodike të monitorimit** që i dorëzohen BERZH-it.